



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:045514

Datë: 03.11.2022

Numri i dokumentit: 03605489

P.nr.08/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me bashkëpunëtor profesional Sylejman Barja, e procesmbajtëse, Atdhetare Bashota, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: R.N, për shkak të veprës penale: Falsifikim i dokumenteve nga neni 390, par. 2, lidhur me par. 1, të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.468/2021 (2021:045514), të datës 11.01.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë 03.10.2022, në praninë e prokurorit të shtetit Slobodan Bakic, të akuzuarit R.N dhe mbrojtësit të tij me autorizim, Av. Mehdi Geci, më datë 04.10.2022 e shpalli publikisht, ndërsa më datë 03.11.2022 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

R.N, nga i ati N..., e ëma Sh..., e vajzërisë B..., i lindur me data e lindjes..., në ..., komuna e Skenderaj, ku edhe tani jeton, pensioner-veteran i luftës, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër të letërnjoftimit..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pagjykuar.

Në mbështetje të nenit 364, par. 1, nënpar.1.3, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPP).

LIROHET NGA AKUZA

Sepse,

Më 09.03.2021, rreth orës 09:30, me vetëdije ka përdorur dokumentin publik të rrejshëm si origjinal, në atë mënyrë që në shërbimin teknik Q... ka sjellë, me qëllim të kontrollimit teknik të automjetin e markës "V...", me ngjyrë të kuqe, viti i prodhimit ..., e me numër të karrocërisë ..., pa targa, të pronarit të mëparshëm M.H nga ..., komuna e Skenderaj, e në të cilën automjet paraprakisht është kryer manipulimi-instalimi (me saldim) i pllakës së aluminit në pjesën e karrocërisë, me numrat e shtypur të cilat nuk i përgjigjen gjendjes reale, respektivisht pllaka dhe numrat në të nuk i përkasin këtij automjeti.

Me çka kishte për të kryer veprën penale: Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK -së.

Shpenzimet e procedurës mbulohen nga mjetet e kësaj gjykate.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

Në mbështetje të nenit 115 par.2, lidhur me nenin 282, par.1 të KPP-së, Urdhërohet konfiskimi i përhershëm i automjetit të markës “G...”, ngjyrë e zezë, me targa te regjistrimit..., me numër te karrocerisë ..., bashkë me librezën e qarkullimit te automjetit. Pas plotfuqishmërisë se këtij Aktgjykimi, Agjencinë për Administrimin e Pasurisë se Sekuestruar dhe Konfiskuar te ndërmarrë veprimet përkatëse ligjore me sendet e konfiskuar.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.468/2021, (2021:045514), të datës 11.01.2022, ndaj të akuzuarit R.N, për shkak të veprës penale: Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor më datat 03.10.2022, ashtu që në këtë seancë i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas aktakuzës. Në këto seanca janë administruar provat materiale, i akuzuari ka paraqitur mbrojtjen e tij dhe palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare mes tjerave theksoj se karrocERIA e automjetit dhe numri i saj është identifikimi i atij automjeti, ku edhe në lejen e qarkullimit është i dhënë numri i karrocerisë, i cili numër e identifikon atë automjet. Më datë 09.03.2021, R.N e ka sjellë atë veturë për kontroll teknike dhe për shkak se ka ekzistuar një dyshim se numrin në karroceri nuk është origjinal, e që është vërtetuar nga ana e ekspertizës së AKF-së, e të cilën ekspertizë mbrojtja nuk e ka kundërshtuar. Prokurori nuk e akuzon R.N për falsifikimin e numrit të karrocerisë së veturës, por e akuzon vetëm shfrytëzimin e dokumentit publik si të vërtetë. Ndërsa kush e ka falsifikuar, përkatësisht kush e ka salduar pllakën e aluminit në automjetin e lartcekur, ne si prokurori nuk kemi arritur ta vërtetojmë. Pasi e ka blerë këtë veturë në tregun e veturave ai këtë veturë e ka regjistruar shumë herë, sipas procedurës, e cila përjashton mundësinë se automjetin e ka blerë me numër të falsifikuar, ngase kjo do të tregonte në rezultatet e kontrollës teknike. Është fakt se ai automjet e ka një vlerë shumë të vogël në treg dhe prokuroria të pandehurin e ndjek penalisht duke pasur parasysh preventiven gjenerale dhe speciale.

Mbrojtësi i të pandehurit R.N, Av. Mehdi Geci, në fjalën përfundimtare, mes tjerave theksoj se, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur si dhe pas administrimit të provave të propozuara nga ana e prokurorisë është vërtetuar plotësisht se i mbrojturi im, R.N, është i pafajshëm dhe nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, sikurse që është vërtetuar se në asnjë rrethanë nuk ka qenë i involvuar në kryerjen e kësaj vepre penale. Ne si mbrojtje nuk e kundërshtojmë raportin e ekspertizës së AKF-së, çka do të thotë se nuk është kontestuese fakti se është ndërruar numri i karrocerisë së automjetit, e poashtu, siç ka potencuar edhe prokurori, në asnjë rrethanë nuk është vërtetuar se i mbrojturi im e ka kryer veprën penale të falsifikimit të dokumentit. I mbrojturi im deklaroi se e ka blerë veturën diku në vitin 2010-2011 dhe çdo herë deri tani e ka bërë regjistrimin në mënyrë të rregulltë, mirëpo ashtu siç deklaroi edhe vete ai, në ditën kritike kur automjetin e ka dërguar në kontrollë teknike nuk ka pasur për qëllim kryerjen e veprës penale. Prandaj, duke pasur parasysh këto, i propozojmë gjykatës që në pajtim me nenin 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, të marr aktgjykim lirues sa i përket të mbrojturit tim, pasi nuk ka palë të dëmtuar, nuk ka

prova që i njëjti ka kryer veprën penale si në aktakuzë dhe gjatë këtij procesi u vërtetua që nuk ka pasur për qëllim kryerjen e veprës penale.

I akuzuari R.N, në fjalën përfundimtare, theksoj se e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij, duke shtuar se nëse do ta dija për një veturë të falsifikuar betohem që menjëherë do ta njoftoja policinë për këtë.

Provat e administruara:

Gjykata, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka administruar provat materiale si në vijim: Raporti policor i datës 09.03.2021, Vërtetimi mbi konfiskimin e mjetit i datës 09.03.2021; Çertifikata e regjistrimit të automjetit për automjetin G..., me numër të librezës...; Raporti nga Qendra e Automjeteve të Kosovës "...", i datës 03.03.2021; Ekspertiza e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, ... i datës 07.04.2021.

Pas administrimit të provave, i akuzuari R.N e paraqiti mbrojtjen e tij, ku mes tjerave theksoj se, veturën e lartcekur e ka blerë në tregun e veturave në Prishtinë, në vitin 2010 apo 2011, por që nuk e ka ditur se kjo veturë ka qenë me numër të falsifikuar të karrocerisë. Ka shtuar se në vitin 2014 këtë veturën ia ka shitur baxhanakut të tij, M.H, por pasi është kthyer nga Suedia, ku ka qenë në Azil, në vitin 2021 përsëri e ka blerë veturën e njëjtë. Pasi e ka blerë ka shkuar në kontrollim teknik, por ata e kanë udhëzuar që të shkoj në Qendrën "...", për shkak të ndryshimit të motorit. Në këtë Qendër i kanë thënë se vetura është e falsifikuar. Tutje në mbrojtjen e tij, ka mohuar se i ka prekur numrat e karrocerisë, duke shtuar se krejt çka din për veturë është me vozitë. Po ashtu ka pohuar se nuk ka pasur njohuri se është e falsifikuar, ndryshe sikur ta dinte do ta lajmëronte rastin vetë. Një deklaratë të ngjashme e kishte dhënë edhe në prokurori, datë 31.03.2021, dhe në polici, datë 09.03.2021

Vlerësimi i gjykatës:

Gjykata, pasi ka administruar provat materiale, mbrojtjen që e ka paraqitur i akuzuari dhe pretendimet e palëve, nuk ka arritur të vërtetojë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nuk ishte kontestues fakti se i akuzuari ishte pronar i automjetit "G...", me targa të regjistrimit..., viti i prodhimit ..., ngjyrë e kuqe. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga deklarami i të akuzuarit, i cili në mbrojtjen e tij e ka pohuar mënyrën si e ka blerë këtë automjet dhe prej kujt e ka blerë.

Nuk ishte kontestues as fakti se, ditën kritike, datë 09.03.2021, i pandehuri kishte shkuar për ta dërguar këtë automjet në kontrollim teknik në Qendrën "E...", me qëllim të pajisjes me certifikate për shkak të ndryshimit të motorit nga 1.6 në 1.9. Kjo është vërtetuar nga mbrojtja e të akuzuarit, i cili ka theksuar se ka shkuar në këtë Qendër me qëllim të evidentimit të ndërrimit të motorit, por kjo rrjedh edhe nga raporti i Qendrës "E...", ku është konstatuar se ky automjet është paraqitur nga pala R.N. Po ashtu, nga vërtetimi për sekuestrimin e automjetit, datë 09.03.2021, vërtetohet fakti se automjeti "G...", me targa të regjistrimit... është sekuestruar nga i akuzuari R.N.

Gjithashtu, nuk ishte kontestues as fakti se vetura "G..." që është objekt i kësaj aktakuzë ishte e falsifikuar, respektivisht numri i karrocerisë së këtij automjeti ishte manipuluar, ku pllaka ku është i vendosur numri i karrocerisë është e salduar e që nuk i përgjigjet numrit të vërtetë. Këtë fakt përveç që nuk e ka kundërshtuar i akuzuari, vërtetohet edhe nga ekspertiza e Agjencisë Forenzikë të Kosovës, datë 07.04.2021, ku është konstatuar se, pllaka ku numri i karrocerisë gjendet i shtypur është e salduar në karrocerinë e veturës së dorëzuar për ekzaminim dhe si i tillë ky numër është i manipuluar dhe nuk i takon kësaj veture. Edhe nga raporti i lëshuar nga Qendra

e Automjeteve të Kosovës “E...”, datë 03.03.2021, konstatohet se, numri i karrocerisë është i salduar dhe nuk është sipas prodhuesit. Pra, nga këto prova gjykata në tërsi e ka vërtetuar faktin se numri i karrocerisë së këtij automjeti ishte i falsifikuar dhe nuk i përgjigjej këtij automjeti.

Megjithatë, Gjykata nuk është lëshuar fare në vërtetimin e faktit se kush e ka kryer këtë manipulim me numrin e karrocerisë, ngase kjo nuk ka qenë objekt i akuzës.

Referuar aktakuzës, prokuroria të akuzuarin e ngarkon se, ka qenë në njohuri se vetura është e falsifikuar dhe kështu është paraqitur me qëllim ta regjistroj këtë veturë.

Prandaj, kontestuese në këtë çështje penale ishte fakti nëse i akuzuari, ditën kritike a kishte njohuri se vetura të cilën ai e kishte dërguar në Qendrën “E...” ishte e falsifikuar dhe se a e kishte falsifikuar i pandehuri.

I akuzuari R.N në shqyrtimin gjyqësor nga fillimi e deri në fund e ka mohuar në tërsi faktin se ka kryer këtë veprë penale. Në lidhje me këtë, i akuzuari, në mbrojtje e tij deklaroj se nuk e ka ditur se vetura të cilën e ka blerë ka qenë me numër të falsifikuar të karrocerisë, si dhe nuk ka pasur për qëllim të falsifikoj.

Duke qenë se i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë, Gjykata, nga provat e administruara nuk ka arritur ta vërtetojë fajësinë e të akuzuarit për këtë veprë penale.

Gjykata vlerëson se asnjë dëshmi materiale, apo edhe dëshmitar nuk është ofruar nga ana e Prokurorisë që do të mund të vërtetonte faktin se i pandehuri ka qenë në dijeni se automjeti ka qenë i falsifikuar-i manipuluar. Vetëm pasja në posedim të automjetit nga ana e të pandehurit respektivisht të një automjeti që ka pasur ndërhyrje në numrin e karrocerisë, nuk janë prova të mjaftueshme që i pandehuri të mund të ketë qenë në dijeni se ky automjet ka qenë i manipuluar, Prokuroria nuk ka ofruar ndonjë prove shtesë që të bind Gjykatën se me të vërtetë i pandehuri ka qenë i përfshirë apo në dijeni se vetura është e falsifikuar.

Asnjë nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk e kanë nxjerr konstatimin se i akuzuari e ka ditur faktik se vetura është e falsifikuar dhe në këtë mënyrë edhe është paraqitur ta regjistroj këtë veturë. Siç është arsyetuar më lartë, ekspertiza e AKF dhe raporti nga Qendra “E...”, në mënyrë të pakontestueshme e vërtetojnë se vetura ishte e falsifikuar, mirëpo këto prova nuk vërtetojnë faktin se i akuzuari ka qenë në njohuri se numri i karrocerisë është i manipuluar.

Nga raporti i policit, datë 09.03.2021 vetëm konstatohet se si është njoftuar policia për ngjarjen, mirëpo nuk përmban asgjë rreth faktit se i akuzuari ka qenë në njohuri se vetura është e falsifikuar. Ndërsa, nga vërtetimi për sekuestrim, tregohet se si është sekuestruar kjo veturë, sikurse nga Certifikata e regjistrimit të këtij automjeti që vërtetohet se kur është regjistruar ky automjet, ku edhe janë shënuar të dhënat për këtë automjet dhe të dhënat e pronarit të saj. Mirëpo, këto prova nuk argumentojnë faktin se i akuzuari ka qenë në njohuri se kjo veturë është e manipuluar.

Në mungesë të provave që do ta vërtetonin fajësinë e të akuzuarit, Gjykata i ka besuar mbrojtjes së të akuzuarit, si për faktin se nuk e ka falsifikuar numrin e karrocerisë, ashtu edhe për faktin se nuk ka qenë në njohuri se kjo veturë është e manipuluar. Gjykata i ka besuar mbrojtjes së tij, ngase kjo mbrojtje nuk binte në kundërshtim me asnjë nga provat e administruara në shqyrtimit gjyqësorë, e për më tepër, mbrojtja e tij në tërsi përputhej edhe me deklaratën e dhënë në prokurori, datë 31.03.2021, në të cilën deklarata e ka mohuar në tërsi faktin se ka qenë në njohuri

se kjo veturë është e falsifikuar, e po ashtu kjo ishte në përputhje edhe me deklaratën e dhënë në polici, datë 09.03.2021, ku e ka mohuar se ka bërë ndonjë ndërhyrje. Pra, në të tri deklaratat e tij, në mënyrë të njëjtë e ka mohuar faktin se ka qenë në njohuri se kjo veturë është e falsifikuar, respektivisht se ka qenë në njohuri për numrin e ndryshuar të karrocerisë.

Në këtë drejtim në mungesë të provave që do t'i vërtetonin veprimet e të akuzuarit, Gjykata i ka besuar mbrojtjes së të akuzuarit se nuk e ka manipuluar numrin e karrocerisë, duke pasur parasysh edhe rrethanat se si është manipuluar ky automjet, ku nga foto-dokumentacioni shihet se vendi ku është bërë manipulimi në numrin e karrocerisë nuk është vend që shihet në mënyrë të zakonshme, por ky numër gjendet në mes të parafangos dhe motorit të veturës, se numri i karrocerisë ... i shtypur në pllakën metalike është sipas standardit "E...", por kjo pllakë është e salduar në karrocerinë e veturës dhe ky numër nuk i përket kësaj veturë. Mirëpo, vetëm pas marrjes se veprimeve përkatëse nga ana e personave të autorizuar-ekspertit me pajisje dhe reagjent kimik, siç konstatohen në ekspertizë, është vërtetuar që numri i karrocerisë është i salduar dhe nuk i përket kësaj veture, pra është i manipuluar, dhe kjo është vërtetuar nga ana e personit të specializuar, e jo vetëm me shikim vizual, që mund të nënkuptohet se i pandehuri mund të mos ketë qenë në dijeni se ky automjeti ka qenë i manipuluar. Prandaj, si përfundim vetëm persona të specializuar dhe me metoda të përshtatshme mund të kenë njohuri se kjo veturë ishte manipuluar.

Mbi bazën e këtyre, Gjykata ka arritur në përfundim se nga provat e administruara nuk ka arritur ta vërtetojë dashjen e të akuzuarit, si element i veprës penale, pra fajësinë e tij, për çka edhe në kuptim të nenit 364, par.1, të KPP-së, ku parashihet se Gjykata nxjerr aktgjykim lirues, par.1.3, "*nuk ka prova me të cilat vërtetohet fajësia e të akuzuarit*".

Gjykata, rikujton një parim kryesor të procedurës penale "In dubio pro reo", përcaktuar në nenin 3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se "mëdyshjet lidhur me ekzistimin e *fakteve të rëndësishme* për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij". Prandaj, duke qenë se Gjykata nuk ka arritur ta vërtetojë përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer këtë veprë penale, atëherë në bazë të kësaj, e ka liruar nga akuza.

Gjykata, edhe për kundër faktit se të akuzuarin e liroi nga aktakuza, e konfiskoi automjetin në fjalë, duke qenë se është vërtetuar në mënyrë të plotë se ky automjet është i falsifikuar dhe si i tillë është jashtë qarkullimit juridik.

Kjo për faktin se, siç ka vërtetuar më lartë Gjykata, nga raporti i ekspertizës së AKF-së, datë 07.04.2021, është konstatuar se automjeti "V...", ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit..., është i falsifikuar, respektivisht numri i karrocerisë ... i salduar në këtë automjet nuk i përket këtij automjeti, e po ashtu edhe etiketa e metalit që i ka të dhënat teknike të veturës që gjendet në këtë veturë është standarde, por nuk i përket kësaj veture. Këtë fakt nuk e ka kontestuar as i akuzuari në asnjë rast, por që sipas tij ai nuk ka qenë në njohuri se është e falsifikuar numri i karrocerisë. Andaj, duke qenë se është vërtetuar se është manipuluar numri i karrocerisë, pra ka pasur ndërhyrje, atëherë Gjykata konstaton se këto ndërhyrje janë veprime të paligjshme dhe si i tillë ky automjet, në mungesë të këtyre të dhëna nuk mund të kthehet në qarkullim juridik dhe si të tilla asnjëherë nuk mund të lejohen të regjistrohen. Prandaj, Gjykata, edhe përkundër faktit se te pandehurin e ka liruar nga fajësia duke marrë për baze edhe sigurinë juridike po edhe atë te përgjithshme, po ashtu është sende që është rezultat i kryerjes se veprës penale siç konstatohet edhe në ekspertizë, në mbështetje të nenit 282 par.1 të KPP-së, ku përcakton se pasuria që është qenësish e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marrë parasysh edhe gjetjet e

gjqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e te pandehurit, po ashtu edhe ne baze te nenit 115 par.2 te KPP-ës, andaj për shkak te këtyre konstatimeve gjykata ka qene e obliguar ta konfiskoj këtë automjet.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 454, par.1, të KPP-së, duke qenë se i akuzuari është liruar nga akuza.

Sa i përket kërkesës pasurore-juridike, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv, ngase në aktakuzë nuk kishte të propozuar palë të dëmtuar.

Andaj, Gjykata duke u bazuar me neni 364, 450, 454, e 463, të KPP-së nga arsyet e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.08/2022, datë 03.11.2022
2021:045514, 03.11.2022

Procesmbajtësja:
Atdhetare Bashota Krasniqi

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.